



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 17 (827973)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 maj 2026



**Shtabi i Përgjithshëm,
vazhdimësia e shtetformimit
ushtarak shqiptar**

Nga nënkolonel Ali Shefqet Shkupi te gjenerallejtënant Arben Kingji

» faqe 10



SHQIPËRIA HYN NË HARTËN E INDUSTRIË USHTARAKE DETARE: MARRËVESHJE HISTORIKE PËR NDËRTIMIN E ANIJEVE NË PASHALIMAN

Shqipëria ka hedhur një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe zhvillimit të industrisë vendase të mbrojtjes, përmes një marrëveshjeje strategjike bashkëpunimi ndërmjet kompanisë shqiptare KAYO sh.a dhe gjigantit italian të ndërtimit të anijeve "Fincantieri". Marrëveshja u firmos në prani të Kryeministrit Edi Rama dhe Ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi, duke shënuar një moment kyç për të ardhmen e sigurisë kombëtare dhe zhvillimit ekonomik të vendit...

faqe 5



75 VITE AVIACION USHTARAK SHQIPTAR NJË HISTORI SHËRBIMI, MODERNIZIMI DHE GATISHMËRIE TË PANDËRPRERË

Në Bazën Ajrore të Kuçovës, u zhvillua një ceremoni solemne për të shënuar 75-vjetorin e Aviacionit Ushtarak Shqiptar, me praninë e Presidentit të Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Blerina Abrashda, Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Edmond Voci, si dhe përfaqësuesve të lartë të Forcave të Armatosura. Aktiviteti përkujtoi një nga degët më të rëndësishme të ushtrisë shqiptare...

faqe 3



ELITA E SË ARDHMES - NGA AKADEMIA SHQIPTARE NË "WEST POINT", RRËFIMI I DY STUDENTËVE QË PREKËN MAJAT E EDUKIMIT USHTARAK BOTËROR

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga Tirana në "West Point" - Dy studentë shqiptarë në gjurmët e liderëve të së ardhmes. Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe programeve të shkëmbimit që Akademia e Forcave të Armatosura zhvillon me institucione homologe, një grup studentësh të përzgjedhur pati mundësinë...

faqe 5



Akademia e Forcave të Armatosura përfaqëson Shqipërinë në CERC 2026

Konferenca Studentore Ndërkombëtare “CERC 2026”, e zhvilluar në **Akademinë Teknike Ushtarake “Ferdinand I”**, konfirmoi edhe një herë rolin e saj si një platformë e rëndësishme bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë universitete prestigjioze nga Europa dhe më gjerë, duke bashkuar studentë, pedagogë dhe ekspertë në një rrjet të gjerë bashkëpunimi akademik dhe kërkimi shkencor. Shqipëria u përfaqësua nga **Akademia e Forcave të Armatosura**, duke kontribuar aktivisht në diskutimet dhe prezantimet shkencore.

“CERC 2026” ofroi një platformë konkrete për shkëmbimin e ideve, zhvillimin e kërkimit të aplikuar dhe forcimin e aftësive profesionale të specialistëve të rinj në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë eksperiencën dhe të ndërtojnë ura bashkëpunimi ndërmjet institucioneve akademike ndërkombëtare. Pjesëmarrja e Akademisë së Forcave të Armatosura në këtë konferencë dëshmon angazhimin për ndërkombëtarizimin e arsimit ushtarak dhe përgatitjen e kuadrove në përputhje me standardet bashkëkohore.

CERC mbetet një model suksesi në ndërtimin e partneriteteve akademike dhe në promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Stërvitje 72-orëshe në Bizë, në kuadër të stërvitjes “Mburoja e Arbrit 26”

Në vazhden e përgatitjeve për stërvitjen “Mburoja e Arbrit 26”, **Kompania II e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë** zhvilloi me sukses një stërvitje intensive 72-orëshe në **Bizë**.

Gjatë këtij aktiviteti, efektivet u përballën me skenarë të ndryshëm taktikë në terren të vështirë, duke testuar aftësitë e tyre në planifikim, reagim të shpejtë dhe bashkërendim operacional. Stërvitja kishte si qëllim rritjen e gatishmërisë për përmbushjen e misionëve në kuadër të operacioneve të Forcave të Armatosura.

Rezultatet e arritura dëshmuuan një nivel të lartë profesionalizmi, disipline dhe përkushtimi nga ana e efektiveve, duke reflektuar standardet e kërkuara për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë.

Kjo stërvitje përbën një hap të rëndësishëm në përgatitjen e njësive për aktivitetin e ardhshëm “Mburoja e Arbrit 26”, si dhe në forcimin e kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore.



Në **Bazën Ajrore të Kuçovës**, u zhvillua një ceremoni solemne për të shënuar **75-vjetorin e Aviacionit Ushtarak Shqiptar**, me praninë e Presidentit të Republikës, **Sh. T. z. Bajram Begaj**, ministrin të Mbrojtjes **Ermal Nufi**, shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, zëvendësministria e Mbrojtjes znj. **Blerina Abrazhda**, Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade **Edmond Voci**, si dhe përfaqësuesve të lartë të Forcave të Armatosura.

Aktiviteti përkujtoi një nga degët më të rëndësishme të ushtrisë shqiptare, e cila prej 75 vitesh ka shërbyer në mbrojtje të hapësirës ajrore të vendit, duke kaluar nga një strukturë fillestare drejt një force moderne të përshtatur me standardet e Aleancës.

Presidenti Begaj vlerësoi kontributin e pilotëve dhe personelit të aviacionit ndër vite, duke e cilësuar këtë forcë si një simbol të përkushtimit, profesionalizmit dhe sakrificës në shërbim të atdheut. Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e vazhdimit të investimeve në teknologji dhe trajnime, në mënyrë që Forca Ajrore të mbetet gjithmonë në gatishmëri dhe në përputhje me standardet e **NATO-s**.

75 vite pas krijimit, Forca Ajrore Shqiptare qëndron si një strukturë moderne, në zhvillim të vazhdueshëm, e angazhuar për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të misioneve të përbashkëta.



75 VITE AVIACION USHTARAK SHQIPTAR

Një histori shërbimi, modernizimi dhe gatishmërie të pandërprerë



Shqipëria dhe SHBA-të forcojnë partneritetin strategjik në mbrojtje: Vizita e ambasadorit të NATO-s në Tiranë dhe Kuçovë

Vizita e ambasadorit amerikan të NATO-s konfirmon mbështetjen për Forcat e Armatosura shqiptare

Në një kohë kur sfidat e sigurisë globale dhe rajonale kërkojnë bashkëpunim gjithnjë e më të ngushtë mes aleatëve, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës konfirmojnë edhe një herë forcën e partneritetit të tyre strategjik. Vizita në Tiranë e ambasadorit të SHBA-së në NATO, **Matthew Whitaker**, solli në qendër të vëmendjes zhvillimet në fushën e mbrojtjes dhe rolin në rritje të vendit tonë në Aleancë.

Ambasadori Whitaker u prit në një takim të veçantë nga ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**. Në fokus të bisedimeve ishte forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dypalësh, si dhe koordinimi mes aleatëve për përballimin e sfidave aktuale të sigurisë.

Partneritet i qëndrueshëm mbi vlera të përbashkëta

Gjatë takimit, palët vlerësuan rëndësinë strategjike të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe SHBA-së, të ndërtuara mbi besim të ndërsjellë dhe vlera të përbashkëta. Ministri Nufi theksoi se mbështetja amerikane ka qenë dhe mbetet thelbësore për zhvillimin e Forcave të Armatosura shqiptare, veçanërisht në fushën e trajnimeve, edukimit ushtarak dhe rritjes së kapaciteteve mbrojtëse.

Ai shprehu mirënjohjen për kontributin e vazhdueshëm të SHBA-së në forcimin e partneritetit strategjik dhe në garantimin e sigurisë në rajon, duke nënvizuar se Shqipëria mbetet një aleat i besueshëm dhe i përkushtuar në kuadër të NATO-s.

Fokus te siguria rajonale dhe sfidat globale

Diskutimet u përqendruan gjithashtu në situatën e sigurisë në rajon, ku u theksua nevoja për bashkëpunim më të ngushtë dhe koordinim të vazhdueshëm mes vendeve aleate. Shqipëria, si pjesë aktive e Aleancës, po rrit rolin e saj në operacionet ndërkombëtare dhe në ruajtjen e stabilitetit.

Ambasadori Whitaker vlerësoi angazhimin e vendit tonë në misionet për paqe dhe stabilitet, si dhe përpjekjet për rritjen e kapaciteteve në fusha të rëndësishme si mbrojtja kibernetike dhe lëvizshmëria ushtarake.



Kuçova, një aset strategjik për NATO-n

Në vijim të vizitës së tij, ambasadori amerikan zhvilloi një inspektim në **Bazën Ajrore të Kuçovës**, një nga investimet më të rëndësishme të NATO-s në Shqipëri. I shoqëruar nga ministri Nufi, ai u njoh nga afër me kapacitetet e kësaj baze të rinovuar, e cila pritet të luajë një rol kyç në arkitekturën e sigurisë rajonale.



Gjatë vizitës, Whitaker theksoi se Shqipëria po shndërrohet gradualisht në një nyje të rëndësishme logjistike për NATO-n në rajon, duke përfutur edhe nga investimet infrastrukturore si Korridori VIII.

Rritja e përgjegjësisë dhe investimeve në mbrojtje

Një nga çështjet e diskutuara ishte edhe rritja e shpenzimeve për mbrojtjen. Ambasadori amerikan nënvizoi pritshmërinë që Shqipëria të vijojë përpjekjet për të përmbushur objektivat e Aleancës në këtë drejtim, duke e parë këtë si një hap të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe të mobilitetit në rajon.

Nga ana e tij, ministri Nufi theksoi se Shqipëria është e vendosur të kontribuojë në mënyrë aktive për paqen dhe stabilitetin, duke rritur bashkëpunimin me aleatët dhe duke forcuar rolin e saj në strukturat e NATO-s.

Një rol në rritje për Shqipërinë në Aleancë

Vizita e ambasadorit Whitaker vjen në një moment të rëndësishëm për vendin tonë, pasi Shqipëria po përgatitet të presë një ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare si samiti i ardhshëm i NATO-s në Tiranë. Ky zhvillim pritet të forcojë më tej pozicionin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti dhe një partner i rëndësishëm në rajon.

Takimet në Tiranë, përfshirë edhe atë me Kryeministrin **Edi Rama**, konfirmuan se marrëdhëniet shqiptaro-amerikane vijnë në një nivel të shkëlqyer, me një bashkëpunim të thelluar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.





Leksione të nivelit të lartë në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë: Fokus te tranzicioni ushtarak dhe sfidat e sigurisë

Në kuadër të programit akademik për vitin 2025–2026, në **Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë** u zhvilluan dy leksione të rëndësishme me fokus në historinë ushtarake dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë.

Në vijim të programit të **Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm**, kursantët zhvilluan një leksion me kolonel (R) **Sali Onuzi**, anëtar i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake. Në cilësinë e të ftuarit të nderit, ai trajtoi temën: “Kalimi i ushtrisë shqiptare nga sistemi socialist monist në sistemin demokratik pluralist, dukuri e probleme”. Gjatë ligjeratës, kolonel Onuzi ofroi një analizë të thelluar mbi sfidat e tranzicionit, transformimin institucional dhe ndikimin e reformave në strukturat dhe kulturën ushtarake shqiptare. Leksioni u zhvillua në formë ndërvepruese, duke u dhënë mundësi kursantëve të shkëmbejnë mendime mbi një periudhë kyçe të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe rëndësinë e përshtatjes me standardet demokratike dhe euroatlantike.

Në një tjetër aktivitet akademik, në kuadër të **Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16)**, u zhvillua një leksion me temë “Krimi i Organizuar dhe Siguria Kombëtare”, i mbajtur nga Dr. **Ervin Karamuço**. Gjatë këtij leksioni, kursantët u njohën me dimensionet bashkëkohore të krimit të organizuar, ndikimin e tij në sigurinë kombëtare dhe sfidat që ai paraqet për institucionet e sigurisë. Diskutimet u fokusuan në analizën e kërcënimeve hibride dhe nevojën për qasje të integruar në luftën kundër krimit të organizuar.

Të dy leksionet u karakterizuan nga një qasje interaktive, duke nxitur mendimin kritik dhe shkëmbimin e ideve mes kursantëve dhe lektorëve, në funksion të përgatitjes profesionale të kuadrove të ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Këto aktivitete dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për të ofruar një formim cilësor dhe bashkëkohor, në përputhje me standardet e NATO-s dhe kërkesat e mjedisit të sigurisë.



Batalioni i Xhenios vijon operacionet për asgjësimin e municioneve në disa bashki të vendit

Batalioni i Xhenios, pjesë e **Komandës Mbështetëse**, vijon me intensitet realizimin e detyrave për vlerësimin, asgjësimin dhe largimin e municioneve luftarake në territorin e vendit. Gjatë operacioneve të fundit, ekipet e specializuara EOD (Explosive Ordnance Disposal) kanë kryer kontrole të detajuara dhe kanë konstatuar municione të kalibrave të ndryshëm në disa zona, përfshirë **Vlorë, Orikum, Këlcyrë dhe Tiranë**.

Për shkak të rrezikshmërisë së lartë, një pjesë e municioneve është asgjësuar në vend, ndërsa të tjera janë transportuar në ambiente të posaçme për trajtim të mëtejshëm, duke ndjekur standardet e sigurisë dhe procedurat përkatëse. Operacionet EOD të Batalionit të Xhenios kanë si objektiv kryesor eliminimin e rrezikut nga mbetjet e municioneve luftarake, duke garantuar sigurinë e komuniteteve lokale, si dhe mbështetjen për strukturat e tjera të **Forcave të Armatosura të Shqipërisë**.

Angazhimi i vazhdueshëm i specialistëve të xhenios dëshmon profesionalizmin dhe përkushtimin në përmbytjen e një misioni të rëndësishëm në shërbim të sigurisë publike dhe kombëtare.



Forcat Speciale shqiptare dhe amerikane zhvilluan stërvitje të avancuar në Zall Herr

Në **Zall Herr**, në fshatin taktik të **Regjimentit të Operacioneve Speciale**, operatorët e Forcave Speciale shqiptare zhvilluan gjatë këtij muaji një stërvitje intensive, nën mbikëqyrjen e instruktorëve të Forcave Speciale të **Shteteve të Bashkuara të Amerikës**.

Stërvitja u fokusua në përmirësimin e aftësive taktike sipas specialiteteve përkatëse, duke kulmuar me një operacion kompleks të përbashkët. Në këtë fazë përmbyllëse, operatorët shqiptarë, në bashkëpunim me partnerët amerikanë, planifikuan dhe ekzekutuan një goditje objekti në prapavijë të kundërshtarit.

Gjatë skenarit stërvitor, Forcat Speciale u infiltruan në zonën e operacionit, realizuan goditjen e objektivit dhe simuluan dhënien e ndihmës së parë në fushë të luftimit. Operacioni përfundoi me eksfiltrimin e sigurt të operatorëve nga zona e veprimit, duke respektuar procedurat standarde të operacioneve speciale.

Stërvitja, e njohur si “Luftim në mjedise të mbyllura dhe në distanca të afërta”, u zhvillua në një terren kompleks dhe kërkues. Ajo u përqendrua në koordinimin e lëvizjeve taktike, reagimin e shpejtë, përdorimin efektiv të armëve dhe veprimin në fshehtësi, me qëllim rritjen e aftësisë së njësisë për të operuar pa u zbuluar dhe për të neutralizuar kërcënimet.

Ky trajnim kishte në thelb forcimin e gatishmërisë operacionale, rritjen e saktësisë dhe përmirësimin e ndërveprimit mes operatorëve, në përputhje me kërkesat e misioneve moderne të operacioneve speciale dhe parimin bazë: “askush nuk mbetet pas”.

Stërvitja në Regjimentin e Operacioneve Speciale konfirmon nivelin e lartë të profesionalizmit të Forcave Speciale shqiptare dhe dëshmon bashkëpunimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm me Forcat Speciale të SHBA-së, si partnerë strategjikë në kuadër të operacioneve të përbashkëta dhe sigurisë kolektive.



Efektivët e Forcës Tokësore morën pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “EFES 2026”, në Turqi

Efektivë nga **Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë të Forcës Tokësore** morën pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “EFES 2026”, e zhvilluar në **Turqi**, një nga aktivitetet më të mëdha stërvitore ndërkombëtare në rajon.

Pjesëmarrja në këtë stërvitje ka si qëllim rritjen e aftësive profesionale të trupave, forcimin e gatishmërisë operacionale dhe përmirësimin e ndërveprimit me forcat e vendeve aleate dhe partnere.

Gjatë zhvillimit të “EFES 2026”, efektivët shqiptarë u angazhuan në skenarë të ndryshëm stërvitorë, të cilët përfshijnë operacione taktike në terrene të ndryshme, koordinim shumëkombësh dhe zbatim të procedurave standarde të NATO-s. Këto aktivitete synojnë rritjen e kapaciteteve për përbashkëpunim dhe situatave komplekse dhe përmbytjen me sukses të misioneve të përbashkëta.

Pjesëmarrja e Forcës Tokësore në këtë stërvitje dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë për të qenë pjesë aktive në aktivitetet ndërkombëtare dhe për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë.



Shqipëria hyn në hartën e industrisë ushtarake detare: Marrëveshje historike për ndërtimin e anijeve në Pashaliman

Shqipëria ka hedhur një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe zhvillimit të industrisë vendase të mbrojtjes, përmes një marrëveshjeje strategjike bashkëpunimi ndërmjet kompanisë shqiptare **KAYO sh.a** dhe gjigantit italian të ndërtimit të anijeve “**Fincantieri**”.

Marrëveshja u firmos në prani të Kryeministrit **Edi Rama** dhe Ministrit të Mbrojtjes **Ermal Nufi**, duke shënuar një moment kyç për të ardhmen e sigurisë kombëtare dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Një projekt me ndikim strategjik dhe ekonomik

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Shqipëria do të prodhojë mjete lundruese në kantierin detar të **Pashaliman**, fillimisht për nevojat e Forcave të Armatosura dhe më pas për eksport në tregjet ndërkombëtare.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes nga administratori i KAYO-s, **Ardi Veliu**, dhe CEO i “Fincantieri-t”, **Pierroberto Folgiero**, Kryeministri Rama e cilësoi këtë bashkëpunim si një hap historik: “Kjo marrëveshje krijon një ekselencë të përbashkët italo-shqiptare në industrinë e kantierëve detare, duke sjellë inovacion dhe teknologji të përparuar në Shqipëri. Do të prodhojmë për Forcat tona të Armatosura dhe për eksport, duke hapur një perspektivë të re zhvillimi”.

Forcimi i kapaciteteve të Forcës Detare

Sipas Kryeministrit Rama, Forcat e Armatosura do të përfitojnë drejtpërdrejt nga ky projekt, me ndërtimin e dy anijeve të para në Pashaliman. Këto njësi do të rrisin kapacitetet operacionale të Forcës Detare, duke e çuar në shtatë numrin total të flotës shqiptare – një nivel i konsideruar optimal në kuadër të angazhimeve të vendit në NATO.

Ndërtimi i mëtejshëm i mjeteve lundruese për eksport synon ta pozicionojë Shqipërinë si një qendër prodhuese rajonale në industrinë detare.

Pashalimani, një qendër e re industriale në rajon

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, theksoi rëndësinë strategjike të projektit, duke nënvizuar se Shqipëria do të shndërrohet në një bazë evropiane të “Fincantieri-t” për prodhimin e anijeve të vogla dhe të mesme.

“Shqipëria bëhet një bazë evropiane e “Fincantierit” për ‘small to medium’. Ky bashkëpunim rrit kapacitetet prodhuese dhe pozicionon KAYO-n si një partner të besueshëm industrial në nivel ndërkombëtar”.

Sipas tij, modeli i biznesit parashikon që mbi 90% e klientëve të jenë ndërkombëtarë, kryesisht klientë ekzistues të kompanisë italiane.

Investim i madh dhe hapje vendesh pune

Projekti parashikon krijimin e një kantieri të ri modern në Pashaliman, me një investim prej rreth 1.2 miliardë eurosh. Ky kantier do të ketë kapacitete për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e anijeve deri në 80 metra gjatësi dhe 800 ton peshë.

Një nga përfitimet kryesore të projektit është punësimi i



Forcat e Armatosura do të përfitojnë drejtpërdrejt nga ky projekt, me ndërtimin e dy anijeve të para në Pashaliman. Këto njësi do të rrisin kapacitetet operacionale të Forcës Detare, duke e çuar në shtatë numrin total të flotës shqiptare – një nivel i konsideruar optimal në kuadër të angazhimeve të vendit në NATO.

rreth 400 specialistëve, si dhe krijimi i mundësive të reja për formimin profesional të të rinjve shqiptarë.

Fokus te të rinjtë dhe formimi profesional

Kryeministri Rama theksoi se projekti do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në arsimimin dhe aftësimin profesional të të rinjve, veçanërisht të nxënësve të shkollës industriale të Vlorës.

Ata do të përfshihen në programe trajnimi të specializuara në bashkëpunim me ekspertë italianë, duke u trajnuar si në Itali ashtu edhe në Shqipëri.

Nga bashkëpunim në projekt konkret industrial

Nga ana e tij, CEO i “Fincantieri-t”, Pierroberto Folgiero, e cilësoi marrëveshjen si një hap përpara nga bashkëpunimi

drejt një projekti konkret industrial me ambicie të qarta: “Kjo marrëveshje përfaqëson kalimin në një fazë të re, me fokus në zhvillimin e produkteve konkurruese për tregun ndërkombëtar dhe në forcimin e industrisë në rajon”.

Një vizion për të ardhmen

Ky bashkëpunim vjen në një kohë kur industria globale e mbrojtjes dhe e ndërtimit të anijeve po përjeton transformime të rëndësishme. Shqipëria synon të bëhet pjesë aktive e këtij transformimi, duke ndërtuar kapacitete moderne dhe duke forcuar rolin e saj në aleancën euroatlantike.

Projekti i Pashalimanit konsiderohet si një nga nismat më ambicioze në fushën e industrisë së mbrojtjes në vend, duke ndërthurur sigurinë kombëtare me zhvillimin ekonomik dhe teknologjik.

ELITA E SË ARDHMES

Nga Akademia shqiptare në “West Point”, rrëfimi i dy studentëve që prekën majat e edukimit ushtarak botëror



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga Tirana në “West Point” - Dy studentë shqiptarë në gjurmët e liderëve të së ardhmes

Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe programeve të shkëmbimit që Akademia e Forcave të Armatosura zhvillon me institucione homologe, një grup studentësh të përzgjedhur pati mundësinë të vizitojë një nga akademitë më prestigjioze ushtarake në botë – “West Point”, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mes tyre ishin edhe studentët e vitit të tretë, Arkel Lahi dhe Sindi Skora, të cilët ndajnë për gazetën “Ushtria” përvojën e tyre, sfidat, dallimet dhe përfitimet që kjo eksperiencë u ka sjellë në formimin e tyre si oficerë dhe liderë të ardhshëm.

“Nuk ishte thjesht fat, ishte rezultat”

Si u përzgjedhët për të qenë pjesë e kësaj vizite dhe çfarë përfaqësonte për ju ky moment?

Studentja Sindi Skora: Përzgjedhja u bazua në performancën akademike dhe disiplinore, që janë ndër kriteret kryesore në akademinë tonë. Nga një grup studentësh me rezultate të larta, u përzgjedhën disa kandidatë dhe më pas u aplikua edhe një short, i cili përcaktoi përfundimisht pjesëmarrësit. Ishte një proces transparent dhe shumë i drejtë.

Kur morëm lajmin, ishte një emocion i veçantë, një ndjesi krenarie dhe përgjegjësie njëkohësisht. E kuptuam menjëherë që po na jepej një mundësi shumë e rrallë për të përjetuar nga afër një realitet që deri atëherë e kishim njohur vetëm në teori.

“Një eksperiencë që formon karakterin”

Sa ndikim ka kjo eksperiencë në formimin tuaj profesional dhe personal?

Studentja Sindi Skora: Ndikimi është i shumanshëm. Nga ana profesionale, kjo eksperiencë na ndihmon të krahasojmë veten me standarde ndërkombëtare dhe të kuptojmë më mirë se ku qëndrojmë. Nga ana personale, është një sfidë që të nxjerr nga zona e rehatisë dhe të ndihmon të rritesh. Kemi përfituar jo vetëm njohuri, por edhe mënyra të reja të menduarit, të organizimit dhe të drejtimit. Është një eksperiencë që të formon si individ dhe si ushtarak.

“Atje nuk përgatiten vetëm oficerë, përgatiten liderë”

Çfarë dallimesh konstatuat midis Akademisë sonë dhe “West Point”?

Studenti Arkel Lahi: Në aspektin e kurrikulave,




Eksperienca në “West Point” për studentët Arkel Lahi dhe Sindi Skora është një dëshmi konkrete e nivelit dhe potencialit që kanë studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Ata përfaqësojnë një brez të ri ushtarakësh, të përgatitur, të motivuar dhe të orientuar drejt standardeve më të larta ndërkombëtare.

nuk kishte dallime të mëdha, pasi akademia jonë është ndërtuar mbi standarde të ngjashme dhe ndjek programe të krahasueshme. Ky ishte një avantazh për ne, sepse nuk u ndjemë të papërgatitur. Ndryshimet kryesore lidhen me infrastrukturën dhe historikun. “West Point” ka një traditë shumë më të gjatë dhe një eksperiencë të konsoliduar ndër vite. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme është se akademia jonë është në zhvillim të vazhdueshëm dhe po ecën me ritme shumë të mira drejt standardeve më të larta.

Çfarë ju bëri më shumë përshtypje gjatë qëndrimit tuaj në “West Point”?

Studenti Arkel Lahi: Ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte filozofia e tyre e formimit të liderëve. Nuk bëhet fjalë vetëm për përgatitje ushtarake në kuptimin klasik, por për ndërtimin e një individi që është i aftë të marrë vendime në situata komplekse, të drejtojë njerëz dhe të mbajë përgjegjësi të mëdha. Disiplina, organizimi dhe serioziteti në çdo aspekt



të jetës akademike janë në një nivel shumë të lartë. Gjithçka është e orientuar drejt përgatitjes së liderëve të së ardhmes.

“Dy rrugë, një qëllim”

A ka ndikuar prejardhja familjare në zgjedhjen tuaj për këtë rrugë?

Studentja Sindi Skora: Në rastin tim, jo. Unë jam e vetmja në familjen time që kam zgjedhur këtë rrugë. Ishte një vendim i ndërgjegjshëm për të ndjekur një profesion sfidues dhe me përgjegjësi. Kjo më ka motivuar edhe më shumë për të treguar se kjo zgjedhje ka qenë e duhura.

Studenti Arkel Lahi: Për mua ka qenë ndryshe. Vij nga një familje me traditë ushtarake, ku gjyshërit kanë shërbyer me devotshmëri në Forcat e Armatosura. Kjo më ka ndikuar në mënyrë të natyrshme në zgjedhjen time. Përveç kësaj, figura e gjyshit tim, i cili ka kontribuar edhe në fushën e botimeve ushtarake, ka qenë një frymëzim i madh për mua.

“Disiplina është çelësi i suksesit”

Sa e rëndësishme është përzgjedhja për një eksperiencë të tillë?

Studenti Arkel Lahi: Është një arritje që vjen si rezultat i një pune të vazhdueshme. Nuk është thjesht fat. Kërkon disiplinë, përkushtim, performancë të lartë akademike dhe përgatitje fizike e psikologjike. Kjo eksperiencë është një shpërblim për përpjekjet dhe njëkohësisht një përgjegjësi për të përfaqësuar denjësisht akademinë tonë.

“Një hap drejt së ardhmes”

Çfarë do të thotë kjo eksperiencë për të ardhmen tuaj?



Studentja Sindi Skora: Na ka ndihmuar të vendosim standarde më të larta për veten. Kemi fituar më shumë vetëbesim dhe kemi kuptuar se çfarë kërkohet për të qenë në nivelet më të mira. Kjo eksperiencë do të ndikojë drejtpërdrejt në mënyrën se si do ta ndërtojmë karrierën tonë.

Studenti Arkel Lahi: Është një bazë shumë e fortë për të ardhmen. Na ka dhënë një perspektivë më të gjerë dhe na ka motivuar të punojmë edhe më fort për të arritur objektivat tona si oficerë dhe liderë.

Çfarë mesazhi do t’u jepnit studentëve të tjerë të Akademisë?

Studentja Sindi Skora: Të besojnë në vetvete dhe të punojnë fort. Mundësitë ekzistojnë dhe janë të arritshme për këdo që është i përkushtuar.

Studenti Arkel Lahi: Suksesi kërkon sakrificë dhe disiplinë. Çdo arritje është rezultat i një pune të gjatë dhe të vazhdueshme.

“Një eksperiencë që tejkalon kufijtë”

Eksperienca në “West Point” për studentët Arkel Lahi dhe Sindi Skora është një dëshmi konkrete e nivelit dhe potencialit që kanë studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Ata përfaqësojnë një brez të ri ushtarakësh, të përgatitur, të motivuar dhe të orientuar drejt standardeve më të larta ndërkombëtare.

Një eksperiencë 10-ditore që shkon përtej një vizite, duke u kthyer në një gur themeli për të ardhmen e tyre profesionale dhe për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve mes institucioneve ushtarake partnere.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Trashëgimia, Vazhdueshmëria dhe Misioni
Bashkëkohor i Shtypit Ushtarak Shqiptar

Historia e shtypit ushtarak shqiptar është një pasqyrë e drejtpërdrejtë e zhvillimeve të shtetit dhe të vetë Forcave të Armatosura. Që nga dalja e numrit të parë të gazetës “Luftëtari” në tetor të vitit 1944, e deri te botimet bashkëkohore si “Ushtria”, kjo traditë përfaqëson një vijimësi të rëndësishme institucionale, historike dhe profesionale.

“Luftëtari”, si gazeta e parë zyrtare e ushtrisë në periudhën e çlirimit, i dha zë përpjekjeve të ushtrisë partizane dhe u shndërrua shpejt në një instrument të rëndësishëm informimi dhe edukimi. Me fillimin e botimit të rregullt në vitin 1945 si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, ajo mori një rol të strukturuar në formimin politik, ideologjik dhe profesional të efektivave ushtarake.

Edhe pse në kontekstin e kohës mbante një karakter të theksuar propagandistik, “Luftëtari” mbetet një burim i rëndësishëm dokumentar për historinë e ushtrisë shqiptare. Mbyllja e saj në vitin 1991 nuk shënoi fundin e shtypit ushtarak, por një pikë kthese drejt një qasjeje të re, më të hapur dhe më profesionale.

Trashëgimia historike dhe rrënjët e shtypit ushtarak

Para dhe pas vitit 1944, shtypi shqiptar ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme çështje që lidhen me ushtrinë. Nga periudha 1912-1939, një pjesë e konsiderueshme e gazetave dhe revistave i kushtonin hapësirë organizimit ushtarak, legjislacionit, strukturave dhe jetës së forcave të armatosura. Kjo krijoi një traditë që u konkretizua më pas në organe të specializuara si “Luftëtari”.

Në këtë mënyrë, tetori i vitit 1944 përbën jo vetëm një moment historik për një gazetë të vetme, por edhe pikënisjen e institucionalizimit të shtypit ushtarak shqiptar.

Roli dhe misioni i gazetës në ditët e sotme

Sot, në një realitet krejtësisht të ndryshëm politik, shoqëror dhe teknologjik, gazeta “Ushtria” vazhdon të mbajë gjallë këtë traditë, duke e përshtatur atë me kërkesat e kohës dhe me standardet moderne të komunikimit publik dhe institucional.

Roli i saj aktual është shumëplanësh dhe thelbësor. Së pari, ajo është një instrument i rëndësishëm për evidentimin dhe promovimin e vlerave historike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet artikujve, analizave dhe materialeve dokumentare, gazeta kontribuon në ruajtjen e kujtesës historike, në nderimin e figurave dhe ngjarjeve të rëndësishme dhe në përcjelljen e kësaj trashëgimie tek brezat e rinj.

Së dyti, “Ushtria” luan një rol të rëndësishëm në pasqyrimin e aktivitetit të përditshëm të Forcave të Armatosura. Stërvitjet ushtarake, operacionet brenda dhe jashtë vendit, angazhimet në kuadër të aleancave ndërkombëtare, si dhe modernizimi i strukturave dhe kapaciteteve mbrojtëse, gjejnë hapësirë të veçantë në faqet e saj. Ky pasqyrim jo vetëm informon publikun, por edhe rrit transparencën dhe besimin ndaj institucionit të ushtrisë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është roli i gazetës në reflektimin e vendimmarrjes politike dhe strategjike në fushën e mbrojtjes. Vendimet e lidhshme politike dhe ushtarake,

Nga ‘Luftëtari’ (1944) te ‘Ushtria’: 82 vite histori, mision dhe transparencë në shërbim të Forcave të Armatosura



reformat në sektorin e sigurisë, politikat e mbrojtjes dhe integrimi në strukturat euroatlantike trajtohen në mënyrë të strukturuar dhe profesionale, duke i dhënë lexuesit një pasqyrë të qartë të drejtimit dhe prioritetëve të Forcave të Armatosura.

Në këtë kuadër, gazeta shërben si një urë lidhëse midis institucioneve ushtarake, vendimmarrjes politike dhe opinionit publik, duke kontribuar në një komunikim më të hapur dhe më të përgjegjshëm.

Nga propaganda te komunikimi profesional

Ndryshe nga periudhat e mëparshme historike, ku shtypi ushtarak kishte një funksion të theksuar ideologjik, sot “Ushtria” operon në një mjedis demokratik, ku theksi vihet te informimi i saktë, analiza profesionale dhe transparenca institucionale.

Ky transformim pasqyron jo vetëm ndryshimet në sistemin politik, por edhe evolucionin e vetë Forcave të Armatosura, të cilat sot janë pjesë e strukturave ndërkombëtare dhe operojnë sipas standardeve moderne të NATO-s.

Në këtë kontekst, roli i gazetës bëhet edhe më i rëndësishëm, pasi ajo kontribuon në ndërtimin e një kulture të re komunikimi dhe në forcimin e marrëdhënieve me publikun.

Saktësia historike dhe vijmësia institucionale

Duke marrë parasysh gjithë këtë rrugëtim historik, nga “Luftëtari” i vitit 1944 deri te “Ushtria” e ditëve tona, bëhet e qartë se kemi të bëjmë me një vijimësi të pandërprerë të shtypit ushtarak shqiptar. Për këtë arsye, përlogaritja e viteve të ekzistencës duhet të nisë pikërisht nga kjo datë themelore.

Çdo pasaktësi në këtë drejtim, si ajo që reflekton një numër më të ulët vitesh, është rezultat i ndryshimeve strukturore dhe institucionale ndër vite, por nuk duhet të cenojë të vërtetën historike. Korrigjimi i saj është një detyrim profesional dhe institucional.

Nga “Luftëtari” te “Ushtria”, shtypi ushtarak shqiptar ka përshkuar një rrugë të gjatë, të mbushur me sfida, transformime dhe arritje. Sot, ai vazhdon të mbetet një element kyç në jetën e Forcave të Armatosura, duke kontribuar në informim, edukim dhe ruajtje të identitetit institucion.

Duke evidentuar vlerat historike, duke pasqyruar aktivitetin e përditshëm ushtarak dhe duke reflektuar vendimmarrjen strategjike, “Ushtria” dëshmon se është jo vetëm një pasardhëse e denjë e “Luftëtarit”, por edhe një institucion modern në shërbim të ushtrisë dhe të shoqërisë.

Ruajtja e kësaj trashëgimie dhe pasqyrimi i saj me saktësi është një përgjegjësi që i përket jo vetëm kësaj gazete, por të gjithë atyre që e konsiderojnë historinë si themel të së ardhmes.

1 Maji – Dita e Punëtorëve

Puna që ndërton shoqërinë, përkushtimi që mbron kombin

Çdo vit, në **Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve**, miliona njerëz në mbarë botën ndalen për të reflektuar mbi vlerën e punës dhe rolin thelbësor të saj në ndërtimin e shoqërive moderne. Kjo ditë nuk është vetëm një festë simbolike, por një moment kujtese për përpjekjet historike të punëtorëve për dinjitet, të drejta dhe kushte më të mira jetese.

Në Shqipëri, 1 Maji mbart një domethënie të veçantë, duke qenë një ditë reflektimi jo vetëm për sektorët civilë, por edhe për ata që shërbejnë në uniformë. Në këtë kontekst, **Forcat e Armatosura të Shqipërisë** përfaqësojnë një ndër shtyllat më të rëndësishme të punës së përkushtuar në shërbim të vendit.

RRËNJËT HISTORIKE TË 1 MAJIT

Historia e 1 Majit lidhet me lëvizjet e fuqishme punëtore të shekullit XIX, të cilat kërkonin kushte më të mira pune dhe reduktimin e orarit të punës. Kjo ditë simbolizon sakrificën dhe solidaritetin e punëtorëve në mbarë botën.

Me kalimin e kohës, kuptimi i saj është zgjeruar, duke përfshirë çdo individ që kontribuon në zhvillimin e shoqërisë nga punëtorët në industri dhe bujqësi, te profesionistët e arsimit, shëndetësisë dhe sigurisë.

PUNA SI MISION NË FORCAT E ARMATOSURA

Në dallim nga shumë profesione të tjera, puna në radhët e Forcave të Armatosura nuk është thjesht një detyrë e përditshme, por një mision i vazhdueshëm në shërbim të atdheut. Ushtarakët nuk punojnë vetëm për të përmbushur detyrimet profesionale, por për të garantuar sigurinë, paqen dhe sovranitetin e vendit.

Puna e tyre karakterizohet nga: **Disiplinë e lartë; Përkushtim i pandërprerë; Gatishmëri për sakrificë; Përballje me rreziqe reale.**

Në çdo moment, ushtarakët janë të gatshëm të ndërhyjnë në situata emergjente, të kontribuojnë në operacione ndërkombëtare apo të përballojnë kriza natyrore dhe humanitare.

NJË ZINXHIR I PANDËRPRERË PUNE

Brenda Forcave të Armatosura, puna nuk kufizohet vetëm në vijën e parë të operacioneve. Ajo është një sistem kompleks ku çdo hallkë ka rëndësi jetike.

Strukturat që mbajnë në këmbë sistemin ushtarak:

- Personeli logjistik** – siguron furnizimin dhe mbështetjen materiale
- Inxhinierët ushtarakë** – ndërtojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën
- Mjekët dhe personeli shëndetësor** – garantojnë kujdesin për efektivët
- Teknikët dhe specialistët** – mirëmbajnë pajisjet dhe sistemet moderne
- Instrukturët dhe pedagogët ushtarakë** – përgatisin brezat e rinj

Ky bashkëpunim i koordinuar është prova më e qartë se suksesi i një ushtrie nuk varet vetëm nga forca luftarake,



por edhe nga puna e përditshme e qindra specialistëve në prapavijë.

PËRKUSHTIMI PËRTEJ KUFIRIT

Ushtarakët shqiptarë janë pjesë aktive e misioneve ndërkombëtare në kuadër të **NATO-s** dhe organizmave të tjerë të sigurisë. Në këto misione, ata përfaqësojnë jo vetëm profesionalizmin e Forcave të Armatosura, por edhe vlerat e punës dhe përkushtimit shqiptar.

Pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe stabilizuese kërkon trajnim të vazhdueshëm, standarde të larta profesionale, aftësi për të punuar në mjedise shumëkombëshe, kjo është një dëshmi se puna e ushtarakut shqiptar ka marrë një dimension ndërkombëtar.

SFIDAT E KOHËS MODERNE

Në botën e sotme, koncepti i punës ka ndryshuar ndjeshëm. Për Forcat e Armatosura, kjo nënkupton përballje me sfida të reja: Kërcënimet kibernetike, Terrorizmi dhe konfliktet hibride; Emergjencat civile dhe katastrofat natyrore; Nevoja për modernizim dhe teknologji të avancuar.

Përballë këtyre sfidave, puna në ushtri kërkon jo vetëm forcë fizike, por edhe dije, inovacion dhe aftësi analitike.

RËNDËSIA E EDUKIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të Forcave të

Armatosura është edukimi i vazhdueshëm. Institucionet arsimore ushtarake luajnë një rol kyç në përgatitjen e kuadrove të rinj, duke i pajisur ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për sfidat moderne.

Investimi në arsim dhe trajnim është një investim në të ardhmen e sigurisë kombëtare.

1 MAJI, NJË DITË REFLEKTIMI DHE MIRËNJOHJEJE

1 Maji është një moment për të vlerësuar çdo formë pune dhe për të shprehur mirënjohje ndaj atyre që kontribuojnë në ndërtimin dhe mbrojtjen e vendit.

Në këtë ditë, nderimi shkon për **ushtarakët në shërbim aktiv, veteranët që kanë kontribuar ndër vite, personelin civil** që mbështet strukturat ushtarake dhe të gjithë ata që punojnë në funksion të sigurisë dhe zhvillimit.

Në thelb, 1 Maji nuk është vetëm një festë e punës, por një kujtesë se çdo arritje e shoqërisë ndërtohet mbi përkushtimin e individëve.

Për **Forcat e Armatosura të Shqipërisë**, puna është më shumë se një profesion, është një mision në shërbim të kombit. Një mision që kërkon sakrificë, disiplinë dhe një ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Në një botë në ndryshim të vazhdueshëm, vlera e punës mbetet e pandryshuar. Dhe kur kjo punë vihet në shërbim të paqes dhe sigurisë, ajo merr dimensionin më të lartë të mundshëm.



Nga nënkolonel Ali Shefqet Shkupi te gjenerallejtënant Arben Kingji

113 vjet

**Shtabi i Përgjithshëm,
vazhdimësia e
shtetformimit
ushtarakshqiptar**





Shtabi i Përgjithshëm i FA-së është institucioni që lidh historinë me të tashmen dhe të ardhmen e shtetit shqiptar. Nga 1913 deri sot, ai ka qenë garant i vazhdimësisë së mbrojtjes kombëtare dhe i zhvillimit të mendimit ushtarak shqiptar.

Më 4 maj 1913, në Vlorën e sapodalë nga shpallja e Pavarësisë, u krijua Shtabi i parë i Forcave të Armatosura shqiptare, Shtabi Madhnuer, i drejtuar nga **nënkolonel Ali Shefqet Shkupi**. Ky moment shënoi lindjen institucionale të komandimit ushtarak shqiptar dhe përfaqëson një nga aktet më të rëndësishme të shtetformimit.

Sot, 113 vite më pas, në krye të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë qëndron **Gjenerallejtënant Arben Kingji**, duke udhëhequr një ushtri moderne, profesionale dhe të integruar në strukturat e NATO-s.

THEMELIMI HISTORIK I SHTABIT (1913)

Ali Shefqet Shkupi dhe krijimi i strukturës së parë ushtarake shqiptare

Shtabi i Përgjithshëm i krijuar, më 4 maj 1913 në Vlorë, nën drejtimin e **Ali Shefqet Shkupit**, përfaqëson strukturën e parë të organizuar të ushtrisë shqiptare.

Në një kohë kur shteti shqiptar sapo kishte shpallur pavarësinë, detyrat e këtij shtabi ishin jetike: organizimi i forcave të armatosura, krijimi i strukturave të komandës, hartimi i rregulloreve të para ushtarake, vendosja e disiplinës dhe hierarkisë ushtarake, mbrojtja e territorit në kushte të rrezikshme gjeopolitike.

Ali Shefqet Shkupi u shndërrua në arkitektin e parë të mendimit ushtarak shqiptar, duke vendosur themelet e një ushtrie kombëtare nga zero. Ai krijoi konceptin e milicisë shqiptare dhe strukturat bazë të komandimit, duke i dhënë formë institucionit që do të evoluonte në dekadat pasuese.

EVOLUCIONI HISTORIK I SHTABIT (1913–1945)

Nga shteti i brishtë te lufta për ekzistencë kombëtare

Gjatë periudhës 1913–1945, Shtabi i Përgjithshëm kaloi nëpër transformime të thella historike:

Periudha e Mbretërisë
Shtabi u institucionalizua si organ qendror i ushtrisë dhe u zgjerua në funksione planifikimi dhe organizimi.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare
Në vitin 1943 u krijua Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ-së, me një strukturë politiko-ushtarake që udhëhoqi luftën për çlirim.

Pas Çlirimit
Në vitin 1945 u riorganizua Shtabi i Përgjithshëm si organ qendror i një ushtrie të rregullt shtetërore. Në këtë periudhë, Shtabi u kthye në instrument kryesor të planifikimit, drejtimin dhe organizimit të forcave ushtarake shqiptare.

PERIUDHA MODERNE (1945–1990)

Nga centralizimi te struktura e konsoliduar ushtarake

Në periudhën e pasluftës, Shtabi i Përgjithshëm u shndërrua në një strukturë të centralizuar, me rol të fortë në: planifikimin operativ-strategjik, organizimin e forcave të armatosura, drejtimin e stërvitjes dhe mobilizimit, kontrollin e strukturave ushtarake në territor.

Figura të rëndësishme të kësaj periudhe përfshijnë:

- Gjeneralmajor Spiro Moisiu
- Gjeneralmajor Mehmet Shehu
- Gjenerallejtënant Petrit Dume
- Gjeneralmajor Beqir Balluku
- Veli Llakaj
- Kiço Mustaqi

Kjo periudhë karakterizohet nga rritja e strukturës ushtarake, por edhe nga një centralizim i theksuar politik dhe doktrinar.

TRANSFORMIMI PAS VITEVE ’90

Nga ushtria e sistemit të mbyllur në ushtrinë e NATO-s

Pas viteve 1990, Forcat e Armatosura shqiptare hynë në një proces të thellë transformimi: reduktim dhe ristrukturim i forcave, profesionalizim i personelit modernizim i doktrinës ushtarake, integrim në partneritetin euroatlantik anëtarësim në NATO (2009). Shtabi i Përgjithshëm u kthye në një organ modern të komandimit strategjik, të ngjashëm me standardet e vendeve aleate. Në këtë periudhë u shquan drejtues si:

- Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi
- Gjeneralmajor Maksim Malaj
- Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi
- Gjeneralmajor Jeronim Bazo
- Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku
- Gjeneralmajor Bajram Begaj
- Gjenerallejtënant Arben Kingji

Kjo është periudha e kalimit nga një ushtri tradicionale në një forcë profesionale dhe ndërvepruese ndërkombëtarisht.

PARALELIZMI HISTORIK DHE KONKLUZIONI

Nga nënkolonel Ali Shefqet Shkupi tek gjenerallejtënant Arben Kingji – dy epoka të një misioni shtetëror

Figura e **Ali Shefqet Shkupit** përfaqëson lindjen e Shtabit të Përgjithshëm dhe krijimin e strukturës së parë ushtarake shqiptare. Ai ndërtoi themelet në kushte mungese totale institucionaliteti. Figura e **Gjenerallejtënant Arben Kingjit** përfaqëson ushtrinë moderne shqiptare, të standardizuar sipas NATO-s, të aftë për operacione ndërkombëtare dhe bashkëpunim strategjik.

Paralelizmi historik

- Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi → krijoi ushtrinë
- Gjenerallejtënant Arben Kingji → drejton ushtrinë moderne
- I pari ndërtoi themelet
- I dyti zhvillon strukturën dhe kapacitetet moderne

Ky është një zinxhir i pandërprerë institucional që lidh 1913 me Shqipërinë e sotme.

113 vite Shtab i Përgjithshëm përfaqësojnë historinë e vetë shtetit shqiptar në dimensionin e tij të mbrojtjes dhe sigurisë.

Nga Vlora e vitit 1913 deri te Shqipëria anëtare e NATO-s, Shtabi i Përgjithshëm ka qenë dhe mbetet boshti i organizimit ushtarak shqiptar dhe simbol i vazhdimësisë shtetërore.

Në këtë rrugëtim historik, nënkolonel Ali Shefqet Shkupi dhe gjenerallejtënant Arben Kingji qëndrojnë si dy pika referimi të një historie të vetme: **shërbimit ndaj Atdheut dhe mbrojtjes së sovranitetit kombëtar**.

Shtabi i Përgjithshëm i FA-së është institucioni që lidh historinë me të tashmen dhe të ardhmen e shtetit shqiptar. Nga 1913 deri sot, ai ka qenë garant i vazhdimësisë së mbrojtjes kombëtare dhe i zhvillimit të mendimit ushtarak shqiptar.

Mesazh Urimi

Stafi i Shtypit Ushtarak, në këtë përvjetor të 113-të të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura: nderojmë me respekt të thellë themeluesin e parë, nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, i cili hodhi themelet e organizimit dhe mendimit ushtarak shqiptar në një nga momentet më vendimtare të historisë sonë kombëtare.

Sot, kjo trashëgimi e çmuar vazhdon të jetojë dhe të zhvillohet nën drejtimin e gjenerallejtënant Arben Kingjit, i cili udhëheq me profesionalizëm, vizion dhe përkushtim Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në një epokë të re, të karakterizuar nga modernizimi dhe integrimi euroatlantik.

Gazeta “Ushtria” i përcjell urimet më të singerta Gjenerallejtënant Arben Kingjit dhe të gjithë efektivëve të Forcave të Armatosura, për shërbimin e tyre të palodhur në mbrojtje të sovranitetit, sigurisë dhe pages.

Qoftë kjo ditë një frymëzim për të vijuar me vendosmëri misionin fisnik në shërbim të Atdheut.

Lavdi traditës, forcë të ardhmes!

NJË HISTORI LIDERSHIPI, sakrifice dhe profesionalizmi NË SHËRBIM TË ATDHEUT

Nga tradita historike te shteti modern

Historia ushtarake shqiptare nuk nis në vitin 1913. Ajo mbështetet mbi një trashëgimi të pasur që shtrihet që nga ushtritë ilire, te epoka e Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e deri te formacionet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këto tradita përbëjnë bazën shpirtërore dhe historike mbi të cilën u ngrit Ushtria Kombëtare Shqiptare.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm në Vlorë, me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të drejtuar nga Ismail Qemali, shënoi institucionalizimin e kësaj tradite në një strukturë moderne shtetërore.

Nga Lufta Nacionalçlirimtare te ushtria moderne

Një moment kyç në historinë e Shtabit të Përgjithshëm ishte periudha e Luftës Nacionalçlirimtare të Shqipërisë. Pas unifikimit të komandës në vitin 1944, në krye të Shtabit u vendos gjeneralmajor Spiro Moisiu.

Pas çlirimit, ushtria shqiptare dhe strukturat e saj kaluan në një proces transformimi drejt një ushtrie të rregullt të kohës së paqes. Shtabi i Përgjithshëm mbeti organi kryesor për drejtimin operacional dhe strategjik, duke u përshtatur me kërkesat e reja të sigurisë kombëtare.

Personalitetet që drejtuan Shtabin e Përgjithshëm

Në historinë e tij, Shtabi i Përgjithshëm është drejtuar nga figura të rëndësishme ushtarake që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e ushtrisë shqiptare.

Ndër to përmenden:

- **Ali Shefqet Shkupi** – drejtuesi i parë i shtatmadhorisë
- **Gustav von Myrdacz** – organizator i ushtrisë në vitet '20-'30
- **Spiro Moisiu** – figurë kyçe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare
- **Mehmet Shehu dhe Beqir Balluku** – drejtues në periudhën pasluftës

Në dekadat e mëvonshme, drejtimi i Shtabit të Përgjithshëm është mbajtur nga një sërë gjeneralësh që kontribuan në modernizimin dhe reformimin e Forcave të Armatosura.

Shtabi i Përgjithshëm sot, një institucion modern

Sot, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura përfaqëson një strukturë moderne, të integruar në arkitekturën e sigurisë euroatlantike. Nën drejtimin e gjenerallejtënant Arben Kingjit, ai vijon të kontribuojë në planifikimin strategjik, menaxhimin e operacioneve ushtarake dhe përgatitjen e forcave për misione ndërkombëtare.

113 vite pas krijimit të tij, Shtabi i Përgjithshëm mbetet një nga institucionet më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Nga një strukturë modeste në Vlorën e vitit 1913, ai është shndërruar në një organ modern drejtimi, i aftë të përballojë sfidat e sigurisë së shekullit XXI.

Kjo histori nuk është vetëm një rrëfim institucional, por një dëshmi e përkushtimit, profesionalizmit dhe sakrificës së brezave të tërë ushtarakësh shqiptarë në shërbim të atdheut.

Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në Ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën “binbash”. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef



113 vite pas krijimit të tij, Shtabi i Përgjithshëm mbetet një nga institucionet më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Nga një strukturë modeste në Vlorën e vitit 1913, ai është shndërruar në një organ modern drejtimi, i aftë të përballojë sfidat e sigurisë së shekullit XXI.

i Shtatmadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit suprem të ushtrisë shqiptare në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës. Braktisi ushtrinë osmane kur ishte komandant i garnizonit të Stambollit.

Gjeneral Ali Riza Kolonja

përveç detyrës si Ministër Luftë në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet '20, pas Kongresit të Lushnjës me Kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e Komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria.

Major Xhavid Leskoviku ka lindur, më 2 maj 1882, në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Dhe është titulluar oficer, më 1 gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vjet me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por më 1 janar 1913 hyn në shërbim të Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemal Bej Vlorës si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vedit.

Major Bajram Fevziu ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket.

U shqua, për besnikëri, atdhetarizëm, vendosmëri dhe aftësi ushtarake. Me gradën major zëvendësoi Xhavit Leskovikun në postin e kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare. Këtë post ai e mbajti edhe me ardhjen e Qeverisë së Fan Nolit. Në krye të Shtabit Madhor, major Fevziu qëndroi deri më 24 dhjetor 1924.

Gjeneral Gustav Von Myrdac me origjinë austriake ishte në postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur, më 7 dhjetor 1876, në Vjenë, kryeqytet i Austro-Hungarisë. Më 18 janar 1925, me riorganizimin e UKSH-së, Myrdac emërohet Kryetar i Shtatmadhorisë dhe organizatori kryesor i UKSH-së. Në vitin 1933 i jepet grada “gjeneral”, që me këtë gradë punoi për UKSH-së deri me pushtimin e Shqipërisë në vitin 1939. Ai rishfaqet përsëri në kohën e pushtimin në tendencat për ngritjen e ushtrisë së pavarur shqiptare nën drejtimin e Komandës së Mbrojtjes



Kombëtare, që me pushtimin gjerman u emërtua: “Komanda Shqiptare e Mbrojtjes”.

Gjeneral Spiro Moisiu lindi në vitin 1900, në qytetin e Kavajës. Moisiu mori pjesë në përbërje të forcave qeveritare që u caktuan në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe po atë vit ai u caktua me detyrën e shefit të shtabit të grupit në luftimet që zhvilluan në Kaptinë të Martaneshit kundra forcave serbe. Në Kryengritjen e Qershorit të vitit 1924, Spiro Moisiu u rreshtua përkrah ushtarakëve të komanduar nga kolonelët Rexhep Shala dhe Kasëm Qafzezi, të cilët u bashkuan me forcat fanoliste. Po kështu në dhjetorin e vitit 1924, Moisiu mori pjesë me forcat qeveritare që dolën në Shkallën e Tujanit për të penguar kthimin e Zogut në Shqipëri. Duke pasur parasysh të kaluarën e tij të papërlyer dhe aftësitë e rralla si ushtarak i karrierës, në korrikun e vitit 1943 kërret e Partisë Komuniste e thërritën atë në Labinot të Elbasanit, ku dhe i propozuan detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai kishte famën e madhe që kishte krijuar Spiro Moisiu si Komandant i Përgjithshëm, në Kongresin e Përmetit, por të gjitha funksionet u përqendruan rreth funksionit politik si Komandant edhe Komisar i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ; ndërsa Spiro Moisiu mbajti vetëm detyrën e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneralkolonel Mehmet Shehu lindi më 10 janar 1913, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka qenë komandant i Çetës Plakë të Mallakastrës në shkurt 1943; komandant i Br1S në gusht 1943, Komandant i D1S në maj 1944 me gradën kolonel, ndërsa në tetor 1944 gradohet gjeneralmajor. Mbas çlirimit të Shqipërisë dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Më pas emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Kryen njëkohësisht detyrën e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të punëve të brendshme. Kryeministër; ndërsa nga 1974 deri në 1981 ka qenë Ministër i Mbrojtjes. Njohës i pesë gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe rusisht.

Gjenerallejtënant Beqir Balluku lindi më 14 shkurt 1917, në Tiranë. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak 1940 deri 1942. Më 20 maj 1943, u caktua komandant i batalionit partizan “Krujë-Ishëm”,



më 18 shtator 1943, komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S. Më 28 janar 1948, ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake “Voroshilov”. Në kongresin e parë të Partisë u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe në vitin, 1953 Ministër i Mbrojtjes Popullore. Një vit më pas mori gradën më të lartë në Shqipëri, atë të gjenerallejtënantit. Balluku ishte gjithmonë deputet i Kuvendit Popullor. Në korrik të vitit 1974 ai u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake nga diktatura, u dënua me vdekje dhe u pushkatua, më 5 nëntor 1975, për tradhti të lartë ndaj atdheut.

Gjenerallejtënant Arif Hasko

Mema lindi në Tërbaç të Vlorës dhe njihej gjatë LIIB me pseudonimin “Patrioti”, gjatë luftës për çlirimin e vendit. Në dhjetor të 1943-it, inkadrohet në BrIS, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik. Më vonë kryen detyra të larta si Komisar Divizioni, Korpusi, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore. Ai tërë jetën e tij, qëndroi besnik i idealeve të LANÇ-it. Ai kreu detyrën e zëvendëskryetarit të Parë të Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it. Për kontributet e tij është nderuar me shumë urdhra e medalje të akredituara nga ish-Presidiumi i Kuvendit Popullor.



Gjenerallejtënant Petrit Dume

lindi më 20 maj të vitit 1920. Ishte deputet, i arsimuar me dy akademi sovjetike ushtarake, shef i shtatmadhorisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë, si shefi më jetëgjatë në shtabin e Përgjithshëm. Ai ka qenë deputet në të gjitha legjislaturat.



Sami Meçollari ishte Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Në periudhën 1970-1972 u caktua shef i shtabit të Korpusit të Gjirokastrës. Në vitin 1973 mori detyrën e komandantit të këtij korpusi deri në vitin 1974, kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.



Veli Llakaj lindi më 18 shkurt 1935, në Kras të Tepelenës. Në vitet 1967-1968, oficer drejtimi pranë SHP; Në vitet 1968-1971 është komandant i BrIK, Tiranë. Në vitet 1971-1972, në Akademinë e SHP dhe Komandant i Korpusit të Burrelit. Në vitet 1972-1974 është komandant i Korpusit të Parë të Mbrojtjes Bregdetare Fier. Në vitin 1974 emërohet zëvendësministër i Parë dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, detyrë të cilën e kryen deri në vitin 1982.



Kiço Mustaqi ishte një ushtarak karriere që kishte lindur më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vjet rresht. Në shkurt të vitit 1991 ngarkohet me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së Kryeministrit Fatos Nano dhe që u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë, në qershor të po atij viti.



Kolonel Halim Abazi, lindi më 18 dhjetor të vitit 1944 në Tërbaç të Vlorës. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në shkurt-qershor 1991, u përzgjedh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të



Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1993.

Gjeneralmajor Kostaq Karoli,

lindi më 18 dhjetor të vitit 1945, në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të Shefit të SHP.



Gjeneral Ilia Vasho,

lindi më 10 korrik 1944, në Leskovik. Mbante gradën shkencore “Dr. Sh.”. Në 1992-1994 u përzgjedh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Dalë oficer në rezervë në vitin 1997, nga funksioni që ka pasur si përfaqësues ushtarak në NATO, funksion që e kreu nga 1994 deri në 1997.



Gjeneral me katër yje Sheme

Kosova. Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sheme Kosova ishte lindur në 24 mars 1949. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në Shef i SHPFASH.



Gjeneralmajor Adem Çopani,

lindi më 10 korrik të vitit 1944, në Tiranë. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e Këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës. Në një nga periudhat më të vështira e të errëta të ushtrisë shqiptare në mars të vitit 1997 zgjidhet në postin madhor të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, detyrë që e mbajti deri në gusht të vitit 1997.



Gjeneral brigade Aleks

Andoni, lindi më 8 qershor 1956, në fshatin Vuno të Vlorës.



Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake.

Gjenerallejtënant Pëllumb

Qazimi, lindi më 21 tetor 1957, në Skrapar. Ka kryer detyrat komandant toge, instruktor stërvitje; zëvendësudrejtor në drejtorinë e zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm, grada nënkolonel; zëvendësudrejtor i Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Gjeneralmajor Luan Hoxha,

lindi më 28 mars 1960, në Shkodër dhe ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008.



Gjeneralmajor Maksim Malaj,

lindi më 13 dhjetor 1958. Gjatë periudhës që Maksim Malaj ka qenë në krye të FASH ka pasur një progres të dukshëm, ku Shqipëria është pranuar anëtare me të drejta të plota në strukturën e sigurisë së kombeve, NATO.



Gjeneralmajor Xhemal

Gjunkshi lindi në Peshkopi, më 30 janar 1963. Me dekret të Presidentit të Shqipërisë Nr.7079 datë 8 gusht 2011, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm.



Gjeneralmajor Jeronim Bazo

ka lindur më 1960, Drejtoi Shtabin e Përgjithshëm nga 3 nëntori 2013 deri në janar 2017.



Gjeneral brigade Bardhyl

Kollçaku lindi në Pëllumbas të Beratit, më 1967. Ka kontribuar për ngritjen në një shkallë më të lartë të stërvitjes e modernizimit të FA-së, për forcimin e kapaciteteve dhe përmbushjen e objektivave strategjikë në kuadrin e direktivave të NATO-s. Forcat e Armatosura nën drejtimin e tij u angazhua për ngritjen e niveleve cilësore ushtarake nëpërmjet shndërrimit në një forcë profesioniste, të mirë stërvitur, të pajisur me sisteme të teknikës dhe të armatimit bashkëkohor si një proces i modernizimit të FA-së në vijimësi.



Gjeneralmajor Bajram Begaj,

lindi më 20 mars 1967, në qytetin e Rrogozhinës. Në vitin 2020, një muaj pas gradimit si Gjeneralmajor, shërbeu si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ka përfunduar studimet doktorale dhe është autor i disa publikimeve shkencore. Nga viti 2016, mban gradën shkencore “Prof. Asoc”. Aktualisht është Presidenti i 8-të i Republikës së Shqipërisë, që prej 24.7.2022.



Gjenerallejtënant Arben Kingji,

lindi më 22 dhjetor 1970, në Kukës. Komandant i Kontingjentit Shqiptar në Irak, Afganistan. Pas diplomimit ka shërbyer komandant toge, Instruktor taktik, drejtues i Grupit Special në Batalionin Komando, Zëvendëskomandant i Batalionit të Forcave Speciale, Komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake, Komandant i Forcës Tokësore, ka shërbyer në katër misione jashtë vendit, si komandant i kontingjentit Shqiptar në Afganistan, Komandant i Kontingjentit Shqiptar në Irak, sot Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



ANJEZA MUSOLLARI, Shefe e Sektorit të Botimeve

Koha që nuk ua dhamë kurrë

Në një kohë kur gjithçka matet me shpejtësi, efikasitet dhe rezultate, kemi harruar të matim diçka thelbësore: praninë. Jo atë fizike, jo atë të shpejtë dhe funksionale, por praninë e vërtetë – atë që kërkon kohë, vëmendje dhe një ndalesë të ndërgjegjshme në ritmin e përditshëm.

Në këtë realitet të ri, prindërit tanë janë bërë pjesë e një zone të heshtur të jetës sonë. Ata janë aty, gjithmonë aty, por shpesh në periferi të kohës sonë. I vizitojmë kur “gjejmë një moment”, i telefonojmë “shpejt e shpejt”, i ndihmojmë me gjëra konkrete – dhe më pas largohemi me nxitim, duke e lënë gjithmonë një hapësirë bosh që mbushet me një fjali të vetme: “herën tjetër”.

Por kjo “herë tjetër” është bërë një nga iluzionet më të mëdha të kohës sonë.

Një shoqëri që nxiton, dhe njerëz që presin

Shoqëria moderne është ndërtuar mbi lëvizjen. Të gjithë jemi në rrugë: drejt një karriere më të mirë, një standardi më të lartë jetese, një jete më të plotë – të paktën në dukje.

Por ndërsa ne lëvizim, dikush ndalon.

Prindërit tanë nuk jetojnë më me të njëjtin ritëm. Jo sepse nuk duan, por sepse koha e tyre ka marrë një tjetër formë. Për ta, dita nuk është një listë detyrash për t’u përmbushur, por një hapësirë që pret të mbushet shpesh me ne.

Ata nuk e thonë këtë. Nuk kërkojnë me zë të lartë. Nuk ankohen. Ata thjesht presin.

Keqkuptimi i madh: Kujdesi nuk është gjithmonë prani

Shumë prej nesh besojnë se janë të pranishëm në jetën e prindërve. Dhe në njëfarë mënyre, kjo është e vërtetë. Ne kujdesemi për ta: u çojmë gjërat që u duhen, u zgjidhim probleme, u japim mbështetje praktike.

Por këtu qëndron një keqkuptim thelbësor: kujdesi nuk është gjithmonë prani.

Mund të bësh shumë për dikë, pa qenë vërtet me të. Mund të kalosh një orë në shtëpinë e tyre, duke parë telefonin. Mund të bisedosh, pa dëgjuar. Mund të përqafosh, pa u ndalur.

Mund të largohesh me ndjesinë se ke bërë mjaftueshëm, ndërkohë që ajo që mungon është pikërisht ajo që nuk matet: koha e ndarë me vëmendje.

Pleqëria nuk është humbje, është privilegj

Në këtë diskutim, ekziston një dimension që shpesh anashkalohet: mënyra se si e shohim plakjen.

Termi “pleqëri” përdoret shpesh me një ngarkesë negative. Si një rënie, si një dobësim, si një fazë që duhet shmangur apo fshehur.

Por kjo është një nga padrejtësitë më të mëdha kulturore të kohës sonë.

Sepse e vërteta është kjo: Të plakesh është një privilegj.

Është një fitore që jo të gjithë e arrijnë. Është koha që të është dhënë për të jetuar më gjatë, për të dashur më shumë, për të parë më shumë nga jeta.

Çdo rrudhë në fytyrën e një nëne apo një babai është një dëshmi jete. Një histori. Një sakrificë. Një përpjekje.

Dhe ndërkohë që ata mbajnë mbi vete gjithë këtë histori, ne shpesh i shohim vetëm si “të moshuar”, si njerëz që kanë nevojë për ndihmë, por jo domosdoshmërisht për kohë. Kjo është një nga gabimet më të mëdha që bëjmë.

Sepse në të vërtetë, ajo që u duhet më shumë nuk është ndihma. Është prania jonë.

Normalizimi i mungesës

Një nga fenomenet më shqetësuese të jetës moderne është normalizimi i mungesës emocionale. Ne jemi mësuar të jemi të zënë. Të justifikojmë mungesat tona. Të shtyjmë takimet familjare. Të reduktojmë marrëdhëniet në komunikime të shkurtra dhe funksionale. Dhe dalëngadalë, kjo bëhet normale.

Një vizitë e shkurtër nuk na shqetëson më. Një telefonatë prej dy minutash na duket e mjaftueshme. Një përqafim i shpejtë konsiderohet i mjaftueshëm.

Por në të vërtetë, këto janë shenja të një largësie që po rritet.

Një largësi që nuk vjen nga mungesa e dashurisë, por nga mungesa e kohës së dhënë me vetëdije.

Heshtja e prindërve: Kur ndalojnë së kërkuari

Një nga aspektet më të ndërlikuara të kësaj marrëdhënieje është fakti që prindërit rrallë e artikulojnë nevojën e tyre.

Ata nuk kërkojnë më shumë kohë. Nuk insistojnë. Nuk bëjnë presion.

Përkundrazi, ata fillojnë të të kuptojnë. **“Të kuptoj që je i zënë”, “E di që ke shumë punë”, “Nuk dua të të shqetësoj”.**

Këto fjali, në sipërfaqe të buta, fshehin një të vërtetë më të thellë: ata po tërhiqen.

“Përqaqimi që e lamë për herën tjetër”



Po mësohen të mos kërkojnë. Dhe ky është momenti më kritik. Sepse kur një prind ndalon së kërkuari kohë nga fëmija i tij, nuk do të thotë se nuk ka më nevojë. Do të thotë se ka filluar të heqë dorë nga pritja.

Teknologjia: Lidhje pa prani

Në epokën digjitale, kemi më shumë mënyra se kurrë për të komunikuar. Mund të flasim çdo ditë, të dërgojmë mesazhe, të ndajmë fotografi. Por kjo nuk do të thotë se jemi më afër. Në shumë raste, jemi më të shpërqendruar.

Një bisedë ndërpritet nga një njoftim. Një moment i përbashkët ndahet me një ekran. Një vizitë kalon mes telefonatave dhe mesazheve. Kjo krijon një iluzion të rrezikshëm: ndjejmë se jemi të lidhur, ndërkohë që në realitet jemi emocionalisht të distancuar. Dhe prindërit e ndiejnë këtë. Jo gjithmonë e thonë. Por e ndiejnë.

Çfarë kërkojnë në të vërtetë?

Nëse do të përpiqeshim ta përkthenim në mënyrë të thjeshtë atë që prindërit tanë duan, lista do të ishte surprizueshëm e shkurtër.

Ata duan: Të kalojnë kohë me ne pa nxitim. Të flasin dhe të dëgohen. Të ndihen pjesë e jetës sonë, jo një ndalesë e saj. Të përqafohen pa formalitet. Të mos jenë gjithmonë “më vonë”. Këto nuk janë kërkesa të mëdha.

Por kërkojnë një gjë që shpesh nuk e japim: vëmendje të plotë.

Koha, forma më e sinqertë e dashurisë

Në fund të fundit, gjithçka reduktohet në një element të vetëm: kohën.

Koha është burimi më i kufizuar që kemi. Dhe pikërisht për këtë arsye, është forma më e vlefshme e dashurisë.

Kur i jep kohë dikujt, i jep diçka që nuk mund ta rikuperosh. Dhe për prindërit tanë, kjo është ajo që ka më shumë rëndësi. Jo sepse kërkojnë shumë. Por sepse e dinë sa pak mbetet.

Një reflektim i nevojshëm

Qëllimi im nuk synon të krijojë ndjenjë faji. As të imponojë një model të vetëm jetese. Ai synon të nxisë një reflektim të thjeshtë: **Sa kohë reale u japim prindërve tanë? Jo në minuta të numëruara.**

Por në prani të vërtetë. Sepse ekziston një ndryshim i madh mes të qenit aty dhe të qenit i pranishëm. Dhe ky ndryshim është pikërisht ajo që përcakton cilësinë e marrëdhënies.

Një zgjedhje e vogël, me peshë të madhe

Nuk kërkojen ndryshime të mëdha për të përmirësuar këtë raport.

Mjaftojnë zgjedhje të vogla: Të rrish pak më gjatë. Të dëgjosh pa ndërprerë.

Të mos shikosh telefonin. Të mos thuash gjithmonë “herën tjetër”. Sepse një ditë, “herën tjetër” mund të mos jetë më një opsion. Dhe atëherë, ajo që do të mbetet nuk janë gjërat që kemi bërë për ta, por momentet që nuk kemi jetuar me ta.

Prindërit nuk kërkojnë shumë

Ata nuk kërkojnë gjithçka. Ata kërkojnë vetëm diçka që ne shpesh e nënvlerësojmë: Kohën tonë. Dhe mbi të gjitha... praninë tonë.

Mos prit një ditë të veçantë për të qenë pranë tyre. Mos e lër për “kur të kesh kohë”.

Koha nuk gjendet. Koha merret.

Telefono sot.

Ulu me ta pa nxitim.

Dëgjoji me vëmendje.

Përqafoji pak më gjatë.

Sepse ata nuk do të të kërkojnë kurrë më shumë nga sa mendon.

Por çdo moment që u jep... është gjithçka për ta.

Dhe një ditë, do të kuptosh se ato çaste të thjeshta... ishin gjërat më të mëdha që kishe.

KRIJIMI I SHËRBIMIT TË PRAPAVIJËS SË USHTRISË SHQIPTARE (1912–1914)

Fillesat e organizimit logjistik të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, në Vlorë shënoi lindjen e një shteti të ri, i cili përballë sfidave të shumta politike, ushtarake dhe ekonomike, kishte nevojë urgjente për krijimin e institucioneve themelore shtetërore. Ndër këto institucione, një rol kyç zuri ngritja e forcave të armatosura kombëtare, të cilat do të garantonin sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit.

Në këtë kontekst, krahas organizimit të strukturave luftarake, lindi domosdoshmëria për krijimin e një sistemi mbështetës – **shërbimi i prapavijës**, i cili do të siguronte furnizimin, veshmbathjen, armatimin dhe mbështetjen logjistike të trupave. Edhe pse në formë fillestare dhe jo e strukturuar plotësisht, ky shërbim përbën bazën e logjistikës moderne ushtarake shqiptare.

KONTEKSTI HISTORIK (1912–1913)

Pas shpalljes së Pavarësisë, Shqipëria u gjend në një situatë të brishtë:

- Territori i saj ishte i paqartë dhe i diskutuar në arenën ndërkombëtare
- Vendi ishte i varfër ekonomikisht dhe pa infrastrukturë shtetërore të zhvilluar
- Forcat e huaja dhe konfliktet ballkanike krijojnë rrezik të vazhdueshëm sigurie

Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e drejtuar nga Ismail Qemali, ndërmori hapat e parë për ndërtimin e një administrate dhe një ushtrie kombëtare.

- Në këtë periudhë:
- Nuk ekzistonte një ushtri e rregullt e mirë organizuar
 - Forcat ushtarake përbëheshin kryesisht nga vullnetarë dhe luftëtarë lokalë
 - Furnizimi dhe organizimi bëheshin në mënyrë spontane dhe të fragmentuar

KRIJIMI I SHTABIT MADHOR – 4 MAJ 1913

Një moment themelor në historinë e Forcave të Armatosura shqiptare është **4 maji 1913**, datë që shënon krijimin e **Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare**.

Në krye të këtij institucioni u vendos: **Major Ali Shefqet Shkupi**, një ushtarak me përvojë në ushtrinë osmane

Rëndësia e këtij momenti: Vendosja e një strukture drejtuese profesionale ushtarake. Fillimi i organizimit të ushtrisë sipas modeleve moderne europiane.

Krijimi i bazës për ndarjen funksionale të strukturave (luftarake dhe mbështetëse).

Krijimi i Shtabit Madhor solli edhe nevojën për organizimin e funksioneve ndihmëse, duke përfshirë:

- Furnizimin**
- Transportin**
- Magazinimin**
- Administrimin e materialeve ushtarake**

Këto funksione përbëjnë thelbin e **shërbimit të prapavijës**.

ORGANIZIMI I USHTRISË NË VITIN 1913

Në gjysmën e dytë të vitit 1913, Ministria e Luftës ndërmori hapa konkretë për organizimin e ushtrisë:

Karakteristikat kryesore:

- Krijimi i një ushtrie të rregullt.
- Struktura të përcaktuara komandimi.
- Disiplinë dhe hierarki ushtarake.
- Përfshirja e forcave aktive dhe rezerve.
- Rekrutimi i popullsisë mashkullore.

Organizimi në njësi dhe reparte

- Fillimi i standardizimit
- Uniforma
- Pajisje bazë



- Armatim (kryesisht i trashëguar ose i siguruar në mënyrë të kufizuar)

FILLIMET E SHËRBIMIT TË PRAPAVIJËS

Edhe pse nuk ekzistonte si strukturë e formalizuar, shërbimi i prapavijës filloi të marrë formë në mënyrë graduale.

Funksionet kryesore të kësaj periudhe:

- Furnizimi i trupave
- Sigurimi i ushqimit për ushtarët
- Organizimi i burimeve lokale
- Mbështetje nga popullsia civile

Veshmbathja

- Përpjekje për krijimin e uniformave standarde
- Përdorimi i veshjeve tradicionale në mungesë të furnizimeve

Armatimi

- Sigurimi i armëve nga burime të ndryshme
- Ripërdorimi i armëve ekzistuese
- Mungesë e theksuar e standardizimit

Transporti

- Përdorimi i mjeteve primitive (kafshë, karroca)
- Lëvizje e kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës

Magazinimi

- Depo të improvizuara
- Ruajtje e kufizuar e materialeve

VËSHTIRËSITË DHE SFIDAT

Shërbimi i prapavijës u përball me sfida të mëdha:

Vështirësi ekonomike

- Mungesë fondesh shtetërore
- Pamundësi për import të rregullt materialesh

Mungesë infrastrukturë

- Rrugë të pazhvilluara

- Transport i vështirë

Situatë politike e paqëndrueshme

- Vendimet për kufijtë në diskutim në arenën ndërkombëtare
- Pasiguri për të ardhmen e shtetit

Mungesë kuadri profesional

- Pak specialistë në logjistikë ushtarake
- Mbështetje në përvojën individuale dhe improvizim

RËNDËSIA STRATEGJIKE E PRAPAVIJËS

Edhe në fazat fillestare, u kuptua se: “Një ushtri nuk mund të funksionojë pa një sistem të qëndrueshëm furnizimi dhe mbështetjeje”.

Roli i prapavijës: Garanton vazhdimësinë e operacioneve ushtarake. Rrit efektivitetin luftarak. Siguron qëndrueshmëri në kushte të vështira.

TRASHËGIMIA DHE ZHVILLIMI I MËVONSHËM

Fillesat e vitit 1913 krijuan bazën për zhvillimin e strukturave moderne, logjistike, organizimin e prapavijës në dekadat pasuese profesionalizimin e shërbimeve mbështetëse.

Këto përpjekje të para, edhe pse modeste, përbëjnë: Themelin historik të logjistikës ushtarake shqiptare. Një dëshmi e vullnetit për ndërtimin e një shteti funksional.

Periudha e majit 1913 përfaqëson një moment kyç në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Krijimi i Shtabit Madhor dhe organizimi fillestar i ushtrisë sollën natyrshëm lindjen e nevojës për një shërbim të strukturuar prapavije.

Megjithëse në kushte të vështira ekonomike dhe politike, përpjekjet e para për furnizim, organizim dhe mbështetje të trupave shënuan fillimin e një sistemi logjistik që do të zhvillohej më tej në vitet dhe dekadat në vijim.

Kjo periudhë mbetet një dëshmi e rëndësishme historike e sakrificës, përkushtimit dhe vizionit për ndërtimin e një ushtrie kombëtare funksionale dhe të qëndrueshme.



Njoftim

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimet e kandidatëve për rezervistë dhe kërkon të rekrutojë 363 kandidatë.

Data e fillimit të stërvitjes: 1 tetor 2026.

Kategoritë që do të rekrutohen:

- | | |
|--|---|
| ☐ Oficer rezervist | 47 (dyzetë e shtatë) kuota |
| ☐ Nënoficer rezervist | 132 (njëqind e tridhjetë e dy) kuota |
| ☐ Ushtar / detar rezervist | 170 (njëqind e shtatëdhjetë) kuota |
| ☐ Mjek / infermier rezervist | 14 (katërmëdhjetë) kuota |

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më: 31 korrik 2026